

Ndryshon Kodi Zgjedhor/Shqiptarët jashtë vendit fitojnë të drejtën për të votuar



Kuvendi i Shqipërisë vendosi ndryshimin e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Ndryshimet e miratuara në Kodin Zgjedhor përcaktojnë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si institucionin i cili do të drejtojë dhe mbikëqyrë procesin për votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet e ardhshme për Kuvendin e Shqipërisë. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor kanë të bëjnë me të drejtën e votës për zgjedhësit që kanë vendbanim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, që janë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Votimi nga jashtë vendit do të quhet i çelur nga dita që KQZ nis procedurat për dërgimin e dokumentacionit të votimit, ose sipas rastit dokumentacionit udhëzues në adresë të zgjedhësve jashtë vendit.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

QSPA, e para qendër kërkimore-shkencore shqiptare që bëhet pjesë e rrjetit akademik ndërkombëtar



Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Ndërkombëtare Ndëruniversitare CISVA, pjesë e së cilës janë universitete të shumta të Italisë dhe Europës Lindore, mes të cilave edhe Universiteti i Tiranës. Koordinatorja shkencore e CISVA-s, prof. ssa Giovanna Scianatico dhe drejtoresha ekzekutive e QSPA-së, prof. Diana Kastrati kanë nënshkruar virtualisht marrëveshjen e bashkëpunimit ndërinstitucional. Kjo është hera e parë që një qendër kërkimore-shkencore shqiptare bëhet pjesë e rrjetit ndërkombëtar akademik, Centro Interuniversitario Internazionale di Studi Sul Viaggio Adriatico, me seli në Bari të Italisë. Pritet që pas kësaj marrëveshjeje, QSPA-ja të ketë mundësi të shfrytëzojë plotësisht literaturën shkencore të CISVA-s, si dhe të bashkërendojë punën për përfshirjen në projekte të përbashkëta ndërkombëtare.

“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”



“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

Qendra e Botimeve për Diasporën publikon falas online fjalorin dygjuhësh për fëmijë shqip-frëngjisht

Qendra e Botimeve për Diasporën publikon falas online fjalorin dygjuhësh për fëmijë, shqip-frëngjisht. Qendra e Botimeve për Diasporën vë në dispozicion të fëmijëve në Diasporë, një tjetër fjalor dygjuhësh për fëmijë: fjalorin shqip-frëngjisht, në formatin e-book. Fjalori, shumë i dobishëm për mësuesit dhe fëmijët në Diasporë dhe jo vetëm, është i shkarkueshëm falas për të gjithë. Fjalori dygjuhësh për fëmijë është konceptuar për fëmijë të moshës deri në 6 vjeç dhe shoqërohet me ilustrime të përzgjedhura me kujdes për t'i qartësuar dhe për t'i konkretizuar edhe më shumë fjalët duke i bërë ato edhe më të kuptueshme për fëmijët. Ky fjalor synon t'u japë fëmijëve të Diasporës një lëndë të pasur për të përmirësuar njohuritë e tyre në gjuhën shqipe, por gjithashtu mund të jetë shumë i vlefshëm edhe në procesin e mësimdhënies.



Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Diaspora i dhuron 5 mijë teste COVID-19 Ministrisë së Shëndetësisë

Në ambientet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u dorëzuan 5 mijë teste COVID-19, të dhuruara për Shqipërinë nga tre biznesmenë të Diasporës shqiptare. Me moton “Së bashku të mbështesim Shqipërinë në luftën kundër COVID-19”, donacioni i sjellë në Tiranë në bashkëpunim me Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare u dhurua nga Lazim Destani President Nderi i Dhomës së Biznesit të Diasporës dhe themelues i kompanisë “Ecolog International”, Nazmi Viqa i kompanisë “Abbruch AWR” dhe Remzi Ejupi i “Eurokoha”. Në ceremoninë e dorëzimit ishin Ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, zv. Ministria Mira Rakacolli, Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, si dhe Skënder Xhakaliu nga Ecolog, Gjermani, i cili përfaqësonte dy donatorët Destani dhe Viqa. Ndërsa donatori i tretë pjesëmarrës ishte Remzi Ejupi nga “Eurokoha”. Sasia prej 5 mijë testesh COVID-19 do t'i shërbejë Institutit të Shëndetit Publik për zgjerimin e kapaciteteve testuese të popullatës.

Aplikacioni Gazeta “Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).



“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

Për më shumë informacione nga Diaspora vizitoni:

www.diasporashqiptare.al